



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 52 Datë 29-05-2025

**MIRATIMIN E RAPORTIT TË KONSOLIDUAR PËR VEPRIMTARINË FINANCIARE DHE
ZBATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË KORÇË PËR VITIN 2024**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi mori në shqyrtim “Raportin e konsoliduar për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të Bashkisë Korçë për vitin 2024”, paraqitur nga Ekzekutivi i Bashkisë, duke u bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” nenit 51 “Raporti vjetor i konsoliduar i zbatimit të buxhetit vendor”, ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.97/2023 datë 07.12.2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, udhëzimin nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, udhëzimin plotësues nr.1 datë 24.01.2024 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”, VKB nr. 167 datë 29.12.2023 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2024 dhe PBA 2024-2026 të Bashkisë Korçë”, VKB nr. 17 datë 15.2.2024 “Për përdorimin e të ardhurave të trashëguara të vitit 2023 të Bashkisë, Institucioneve të Varësisë në buxhetin e vitit 2024”, si dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore,” mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimeve dhe propozimeve të këshilltarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë raportin e konsoliduar për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të Bashkisë Korçë për vitin 2024.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ekzekutivi i Bashkisë Korçë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Eva NAÇI

Miratur me 23 vota
Vota Pro 23
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 1
Zbardhur më datë 29-05-2025



KRYETAR
Ana VERUSHI